

Banka ProCredit sha, Rr. "Dritan Hoxha", Tiranë, Shqipëri.

RREGULLA SIGURIE PËR PËRDORIMIN E KARTËS

Banka ofron mundësinë e kryerjes së transaksioneve bankare me kartë. Këto transaksione mundësohen duke përdorur kodin PIN dhe elementët e sigurisë së kartës. Mbajtësi i kartës duhet të zbatojë rregullat e sigurisë si më poshtë:

1. Mbajtësi i kartës duhet të sigurohet dhe të marrë masa për blerjet që bëhen online duke verifikuar me kujdes kompaninë dhe faqen e Internetit ku vendos shënimet e kartës.
2. (Kujdes: Kur blerja bëhet nga një website i sigurt, adresa e faqes që përmban informacionin e kërkuar të kartës së kreditit/debitit do të ndryshojë nga "http" në "https". Ky fakt verifikon që website-i përmban certifikatë të verifikueshme sigurie (SSL). Mbajtësi i kartës duhet të kontrollojë këtë certifikatë duke klikuar sipër ikonës në formë dryni dhe në këtë mënyrë të sigurohet që kompania në fjalë është e vërtetë dhe se informacioni i dërguar nëpërmjet kësaj faqeje është i padeshifrueshëm).
3. Mbajtësi i kartës duhet të kryejë veprimet financiare në një kompjuter të sigurtë jo të aksesueshëm nga persona të tjerë të paautorizuar (p.sh. rekomandohet të kryhen veprime në kompjuterin e shtëpisë ose laptopin personal).
4. Rekomandohet që në fund të çdo blerjeje online mbajtësi i kartës duhet të printojë në letër ose të mbajë të dhënat për transaksionin e bërë dhe mundësisht të ruhet derisa procesi i blerjes me kartë krediti të ketë përfunduar plotësisht me sukses.
5. Mbajtësi i kartës duhet të ketë kujdes të mos japë të dhëna për kartën (fjalëkalimin, PIN, apo të dhëna të tjera përmes e-mailit apo telefonit), pasi Banka asnjëherë nuk kontakton mbajtësin e kartës për ta pyetur për këto informacione.
6. Në rast se mbajtësi i kartës nuk i përmbahet këtyre këshillave të sigurisë, ai mban përgjegjësi të plotë për humbjet që mund të shkaktohen deri në momentin kur klienti lajmëron bankën për probleme me kartën dhe të bllokohet kjo e fundit.
7. Banka nuk mban asnjë përgjegjësi për çdo humbje apo keqpërdorim të kartës nga ana e klientit, në rast se klienti nuk e njofton Bankën në kohën e duhur. Banka nuk do të jetë përgjegjëse në rastet e ndonjë dëmtimi direkt apo indirekt që mund të vijë si pasojë e keqinstalimeve apo difekteve teknike në software.